





5th
AUTOSTRADA
BIENNALE

UNFOLDING
CURRENTS:
THE PULSE
OF TIME



5th
AUTOSTRADA
BIENNALE

UNFOLDING
CURRENTS:
THE PULSE
OF TIME

The fifth edition of the Autostrada Biennale
curated by Erzen Shkololli
Edicioni i pestë i Autostrada Biennale
kuruar nga Erzen Shkololli

Unfolding Currents: The Pulse of Time
Rrymat që Shpalosen: Pulsi i Kohës

05.07—05.10.2025, Prizren

CONTENTS

PËRMBAJTJA

Foreword Parathënie	6
Curatorial Concept Koncepti Kuratorial	10
Participating Artists Artistët Pjesëmarrës	19
Visitor Information Informatat për Vizitorët	20
Map of Prizren Harta e Prizrenit	22
Map of ITP Zone Harta e Zonës ITP	24
Map of Historical Zone Harta e Zonës Historike	54
Public Program Programi Publik	84
Sponsors and Partners Sponsorët dhe Partnerët	92
Colophon Kolofoni	94

(ENG) Dear friends and partners,

We never imagined this would be easy. But we always hoped it would be meaningful. When we began this journey, our ambition wasn't to build something big—it was to build something true. A space where contemporary art could grow not apart from everyday life, but alongside it. A space that listens as much as it speaks. That doesn't rush, but roots itself—here in Prizren, among people, stories, and time.

Now, five editions later, we welcome you with full hearts and a quiet sense of wonder. Not because everything has gone as planned—it hasn't. But because, despite everything, we are still here. Still building. Still believing that art, when held with care and courage, can open paths where none seemed possible.

This fifth edition arrives at a time when the world feels fragile in many ways. Maybe that's why it feels even more important to gather—to hold space for reflection, for art, for simply being present with one another.

We're proud of what this edition holds, curated by Erzen Shkololli, and we invite you to experience it slowly, in your own rhythm, in your own way.

We've grown, yes—through the Biennale itself, through the creation of the Autostrada Hangar—our Center for Contemporary Art now rooted in the city—and through a program that unfolds across the seasons. Yet we are still walking with the same questions: How do we stay grounded? How do we grow in ways that serve not only ourselves, but those around us? How do we keep art open—accessible, honest, alive?

To everyone who has met us on this road—artists, collaborators, neighbors, friends, supporters, partners, visitors—thank you. This Biennale belongs to all of you. It's a reminder that art is not a destination, but a movement. And we're honored to be moving with you.

Warmly,

Leutrim Fishekqiu, Vatra Abrashi,
Bariş Karamuço
*Co-Founding Directors
of Autostrada Biennale*

(ALB) Të dashur miqë dhe partnerë,

Asnjëherë s'kemi menduar se do të jetë e lehtë. Por gjithmonë kemi shpresuar se do të ketë kuptim. Kur nisëm këtë rrugëtim, ambicia jonë nuk ishte që të ndërtonim diçka të madhe, por që të ndërtonim diçka të vërtetë. Një hapësirë, ku arti bashkëkohor do të mund të rritej krahë jetës së përditshme dhe jo të shkëputet nga ajo. Një hapësirë që aq sa flet, edhe dëgjon. Një diçka që nuk ngutet, por lëshon rrënjë këtu në Prizren, mes njerëzve, rrëfimeve dhe kohës.

Tani, pesë edicione më vonë, ju mirëpresim me zemra të plota dhe një ndjenjë të heshtur të mrekullimit. Jo se çdo gjë ka shkuar sipas planit—përkundrazi. Por sepse, pavarësisht nga të gjithat, prapëseprapë jemi këtu. Ende duke ndërtuar. Ende duke besuar se arti, kur mbahet me kujdes dhe guxim, mund të rrahë shtigje aty është dukur e pamundur.

Ky edicion i pestë vjen në një kohë kur bota ngjan e brishtë në shumë mënyra. Mbase për këtë arsye është ende më e rëndësishme të mblidhemi—të japim një hapësirë për reflektim, për art dhe thjesht për të qenë të pranishëm me njëri-tjetrin. Jemi krenarë me përmbajtjen e këtij edicioni të kuruar nga Erzen Shkololli dhe ju ftojmë ta përjetoni ngadalë, me ritmin tuaj, në mënyrën tuaj.

Jemi pjekur, po—përmes vetë Bienales, përmes krijimit të Autostrada Hangar, Qendrës sonë për Art Bashkëkohor që tanimë ka zënë vend në qytet—dhe përmes një programi që shpaloset përgjatë stinëve. Sidoqoftë ende shoqërohemi nga pyetjet e njëjta: si të qëndrojmë me këmbët në tokë? Si të zhvillohemi në mënyra që nuk na shërbejnë vetëm neve, por edhe të tjerëve rreth nesh? Si ta mbajmë artin të hapur—të qasshëm, të çiltër, të gjallë?

Të gjithëve që na kanë ndeshur në këtë rrugë—artistët, bashkëpunëtorët, fqinjët, miqtë, mbështetësit, partnerët, vizitorët—ju falënderojmë. Kjo Bienale ju përket të gjithë juve. Është një përkujtim që arti nuk është një pikëmbërritje, por një lëvizje. Dhe kemi ndërin të lëvizim së bashku me ju.

Përzemërsisht,

Leutrim Fishekqiu, Vatra Abrashi,
Bariş Karamuço

*Drejtorët bashkëthemelues të
Autostrada Biennale*

UNFOLDING CURRENTS: THE PULSE OF TIME

RRYNAT QË
SHPALQSEN:
PULSI I
KOHËS

CURATORIAL CONCEPT KONCEPTI KURATORIAL

(ENG) The fifth edition of the Autostrada Biennale, *Unfolding Currents: The Pulse of Time* highlights the dynamic interplay between artists, artworks, audiences, and the rich historical context of Prizren, Kosovo.

A city layered with architectural and cultural history, Prizren serves as a living repository of the country's heritage. Now in its tenth year, the Autostrada Biennale adopts a situated approach, inviting artists from various generations and geographies to engage deeply with several of the city's historical sites. By reimagining past works and commissioning new projects, this edition fosters a vibrant dialogue with the present while critically reflecting on the past.

The title *Unfolding Currents: The Pulse of Time* embodies the spirit of this dialogue. "Unfolding Currents" evokes the continuous evolution of historical and artistic narratives, while "The Pulse of Time" captures the rhythmic, persistent nature of these transformations. The title underscores the biennale's active engagement with the layered contemporary moment we inhabit.

Situated along the Prizren river, the city is composed of many pasts and presents. Formed over millennia by a retreating glacier, Prizren—now the second-largest city in Kosovo—lies at the foothills of the Sharr Mountains. Bronze Age fragments have been uncovered around the city's historical fortress. Byzantine churches stand alongside significant Ottoman mosques and residences. Many examples of Yugoslav infrastructure remain in use, while the traces of the Kosovo War mark nearly every surface.

The exhibition unfolds across several historical sites, from the Clock Tower and Shani Efendi House to the Gazi Mehmed Pasha Hammam and beyond. Many of the featured projects are already taking shape. This announcement invites readers and future visitors on a journey through these key sites, where they can encounter the projects as they develop.

As the curator of the fifth edition of the Autostrada Biennale, I am honored to lead this initiative. As a curator from Kosovo, I have a deep understanding of both the groundedness and fragility of artistic practice here.

The temporary nature of the artworks in *Unfolding Currents: The Pulse of Time* means that many of their vibrant questions and proposals will inevitably fade. Nevertheless, these projects are designed to leave a lasting impression on both our collective memory and the city's fabric. The legacy of previous editions—seen in the work of Open Group, Neda Saeedi, and Alban Muja—demonstrates how artistic contributions continue to evolve and resonate.

The history of Prizren—marked by memory, erasure, and trauma—shapes our curatorial approach and reflects the resilience of Kosovar culture. This edition seeks to honor and build upon that legacy by exploring new ways of engaging with and preserving our heritage spaces. The Autostrada archive—which is expanding in parallel with this biennale—serves as an important repository for artist publications, biennale materials, and evolving insights.

My hope is that *Unfolding Currents: The Pulse of Time* will foster meaningful dialogue and reflection for artists and audiences alike, both now and in the future.

Warmly,

Erzen Shkololli

Curator of the fifth edition of Autostrada Biennale

(ALB) Edicioni i pestë i Autostrada Biennale, *Rrymat që Shpalosen: Puls i Kohës* thekson ndërveprimin dinamik mes artistëve, veprave të artit, audiencës dhe kontekstit të pasur historik të Prizrenit.

Si qytet me shtresa të shumta arkitekturore dhe kulturore, Prizreni shërben si visar i gjallë i trashëgimisë së vendit. Për përvjetorin e saj të dhjetë, Autostrada Biennale do të ndjekë një qasje të përshtatur ndaj mjedisit, duke ftuar artistë të brezave dhe vendndodhjeve të ndryshme që të angazhohen thelbësisht me disa nga monumentet kulturore të qytetit. Përmes ripërfytyrimit të veprave ekzistuese dhe komisionimit të projekteve të reja, ky edicion do të nxitë dialog të gjallë në të tashmen duke reflektuar në mënyre kritike për të kaluarën.

Titulli *Rrymat që Shpalosen: Puls i Kohës* mishëron frymën e këtij dialogu. Fraza “Rrymat që Shpalosen” sjell ndër mend evoluimin e vazhdueshëm të narrativave historike dhe artistike, ndërsa “Puls i Kohës” ngërthen natyrën ritmike dhe të pareshtur të këtyre shndërrimeve. Titulli nxjerr në pah angazhimin aktiv të bienales me çastin shumështrësesh në të cilin jetojmë.

I shtrirë përgjatë lumit, Prizreni përbëhet nga shumë të shkuara dhe të tashme. I formuar para shumë mijëvjeçarësh me mbarimin e periudhës akullnajore, Prizreni, i cili sot është qyteti i dytë më i madh në Kosovë, gjendet në rrëzë të Vargmaleve të Sharrit. Përreth kalasë së saj janë zbuluar fragmente nga Epoka e Bronzit. Kishat bizantine qëndrojnë përkrah xhamive dhe shtëpive të shquara të periudhës osmane. Shumë shembuj të infrastrukturës jugosllave mbesin ende në përdorim, ndërsa pasojat e luftës së fundit në Kosovë spikatin thuajse në çdo cep.

Ekspozitat shpalosen në disa monumente historike, duke përfshirë ndër të tjera Sahatkullën, Shtëpinë e Shani Efendiut dhe Hamamin e Gazi Mehmed Pashës. Shumë projekte që do të shfaqen tashmë kanë filluar të marrin trajtë. Kjo shpallje

fton lexuesit dhe vizituesit e ardhshëm t'i bashkohen një rrugëtimi përgjatë hapësirave kyçe ku mund të njihen me këto projekte që janë në zhvillim e sipër. Si kurator i edicionit të 5-të të Autostrada Biennale *Rrymat që Shpalosen: Puls i Kohës* ndihem i nderuar të udhëheq këtë edicion. Si kurator nga Kosova e kuptoj thellësisht maturinë dhe brishtësinë e praktikës artistike këtu.

Natyra e përkohshme e veprave artistike në *Rrymat që Shpalosen: Puls i Kohës* do të thotë që shumë aspekte të pyetjeve dhe propozimeve që shtrojnë, përkundër gjallërisë së tyre, do të zbehen. Pavarësisht nga kjo, këto projekte janë të ndërtuara për të lënë mbresa afatgjata edhe në kujtesën tonë, edhe në kuadrin e qytetit. Trashëgimia që kanë lënë pas edicionet e kaluara përmes veprave të Open Group, Neda Saeedi-t dhe Alban Mujës theksojnë mënyrën se si këto kontribute artistike vazhdojnë të evoluojnë dhe të kumbojnë.


Historia e Prizrenit, e cila është e shënuar nga kujtesa, shlyerja dhe trauma, i jep trajtë qasjes sonë dhe pasqyron paepurinë e kulturës kosovare. Ky edicion synon ta nderojë këtë trashëgimi dhe ta zgjerojë atë më tej duke eksploruar mënyra të reja të ndërveprimit me objektet e trashëgimisë kulturore dhe të ruajtjes së tyre. Arkivi i Autostradës—i cili pasurohet paralelisht me këtë edicion të bienales—shërben si depo e rëndësishme për botimet e artistëve, materialet e bienales dhe këndvështrimet në zhvillim e sipër.


Shpresa ime është *Rrymat që Shpalosen: Puls i Kohës* do të ushqejë dialogun domethënës dhe reflektimet e artistëve e të audiencës, si tani ashtu edhe në të ardhmen.


Përzemërsisht,

Erzen Shkololli

Kurator i edicionit të pestë të Autostrada Biennale







PARTICIPATING ARTISTS
ARTISTËT PËSËMARRËS:
BLERTA HASHANI, DAVID
FESL, BRILANT MILAZIMI,
ANITA MUÇOLLI, DORUNTINA
KASTRATI, STEPHANIE
RIZAJ, EDIN ZENUN, ROBERT
GABRIË, ARMEND NIMANI,
ELENA NARBUTAITE, SILYA
AGOSTINI, SMALL BUT
DANGERS, HASSAN KHAN,
LAURENT MARESCHAL, TAO
G. YRHOVEC SAMBOLEC,
NIKA ŠPAN, RIVANE
NEUENSCHWANDER, NATHAN
COLEY, YADIM FISHKIN,
TAMARA GRČIĆ, AYŞE
ERKMEN, ALIJE YOKSHI,
LOIS WEINBERGER,
SIMON SHIROKA.

VISITOR INFOR- MATION INFORMATAT PËR VIZITORËT



Autostrada
Biennale
Website



Autostrada
Biennale
Facebook



Autostrada
Biennale
Instagram



Autostrada
Hangar
Facebook



Autostrada
Hangar
Instagram



Autostrada
Hangar
Tiktok

(ENG) Exhibition venues are open to the public from Wednesday to Sunday 10:00–17:00 (Closed on Monday & Tuesday). All exhibition venues are free to enter.

Info points in two venues:

AH - Autostrada Hangar - Center for Contemporary Art
(Autostrada Shop, Vegetarian Kitchen, Coffee, Library and Exhibition Space)

Rruga Ukë Bytyqi, ITP Prizren, Building no: 05 / Objekti nr: 05

SEH - Shani Efendi House
(Autostrada Shop and Exhibition Space)
Rruga Farkëtarët

For more detailed information on events, the vegetarian kitchen menu, co-working space and educational programs, please follow us on social media, visit our website, or get in touch.

(ALB) Hapësirat ekspozuese janë të hapura për publikun nga e mërkura deri të dielën, prej orës 10:00 deri në 17:00. (Të mbyllura të hënën dhe të martën). Hyrja në të gjitha hapësirat ekspozitës është falas.

Pikat informuese në dy lokacione:


AH – Autostrada Hangar – Qendra për Art Bashkëkohor
(Autostrada Shop, Kuzhina Vegjetariane, Biblioteka, Kafeteria dhe Hapësira Ekspozuese)
Rruga Ukë Bytyqi, ITP Prizren, Objekti nr: 05

SEH – Shtëpia Shani Efendi
(Autostrada Shop dhe Hapësira Ekspozuese)
Rruga Farkëtarët

Për informata më të detajuara rreth ngjarjeve, menuse së Kuzhinës Vegjetariane, hapësirës së përbashkët pune dhe programeve të edukimit, na ndiqni në rrjetet sociale, vizitoni faqen tonë të internetit ose na shkruani.

MAP OF PRIZREN

HARTA E PRIZRENIT



Historical Zone / Zona Historike:

SEH - Shani Efendi House
Shtëpia e Shani Efendiut

GMPH - Gazi Mehmed Pasha Hammam / Hamami i Gazi Mehmed Pashës

DFH - Dorambari Family House
Shtëpia e Familjes Dorambari

AM - Archaeological Museum and Clock Tower / Muzeu Arkeologjik dhe Sahatkulla

Performance Venue in City Centre
Hapësira për Përfomancë në Qendër të Qytetit:

***MB - Marin Barleti Street** / Rruga Marin Barleti

AH - A permanent space of Autostrada Biennale is Autostrada Hangar in ITP Prizren - Center for Contemporary Art / Hapësira e përhershme e Autostrada Biennale është Autostrada Hangar në ITP Prizren - Qendra për Art Bashkëkohor

Exhibition and Performance Venues of 5th Edition of Autostrada Biennale
Hapësirat për Ekspozita dhe Performanca të Edicionit të 5-të të Autostrada Biennale:

ITP - Innovation and Training Park
Parku i Inovacionit dhe i Trajnimeve:

AH - Autostrada Hangar Center for Contemporary Art

H3 - Hangar 3
ITP Building 03 / ITP Ndërtesa 03


H9 - Hangar 9
ITP Building 09 / ITP Ndërtesa 09

H10 - Hangar 10
ITP Building 10 / ITP Ndërtesa 10

***ITP - ITP Outdoor**
Hapësirat e jashtme në ITP

MAP OF ITP ZONE

HARTA E ZONËS ITP



AH1 - Autostrada Hangar 1
ITP Building 05 / ITP Ndërtesa 05

AH2 - Autostrada Hangar 2
ITP Building 08 / ITP Ndërtesa 08

AR - Autostrada Artist Residency
Autostrada Rezidenca për Artistë
ITP Building 07 / ITP Ndërtesa 07

OTH - Autostrada & ITP: Open Air Theatre / Teatri i Hapur
ITP 06 / ITP 06

H3 - Hangar 3
ITP Building 03 / ITP Ndërtesa 3
Tamara Grčić
Ayşe Erkmen

H9 - Hangar 9
ITP Building 09 / ITP Ndërtesa 09
Hassan Khan

H10 - Hangar 10
ITP Building 10 / ITP Ndërtesa 10
Armend Nïmani
Brilant Milazimi
Rivane Neuenschwander
Elena Narbutaitė

***ITP - ITP Outdoor**
Hapësirat e jashtme në ITP
Lois Weinberger
Nathan Coley
Silva Agostini

ITP ZONE ZONA ITP

AUTOSTRADA HANGAR —CENTER FOR CONTEM- PORARY ART AUTOSTRADA HANGAR—QENDRA PËR ART BASHKËKOHOR

(ENG) Autostrada Hangar is the result of our vision, journey, and commitment to making contemporary art accessible to everyone. Founded in 2014 by Leutrim Fishekqiu, Vatra Abrashi, and Bariş Karamuço, Autostrada Biennale was born from the desire to create a space where art could live alongside everyday life and resonate with people from all walks of life.

In 2017, we launched the first edition of the Biennale in Prizren, a city with no gallery space and little exposure to contemporary art. What began as a bold idea quickly became a vital part of the region's cultural landscape, offering a platform for global artists to connect with the local community and turning art into something that belonged to all of us.

As the Biennale grew, we realized the need for a permanent space to create, collaborate, and engage year-round. In 2020-2021, we transformed a former German KFOR military hangar structure into Autostrada Hangar – Center for Contemporary Art, a venue where exhibitions, workshops, performances, and public programs bring the community together.

Sustainability has always been at the heart of our mission. Half of the materials used to build both Hangars were repur-

Address: Rruga Ukë
Bytyqi, ITP Prizren,
Autostrada Hangar 1,
Building No. 05



posed from past Biennale editions, reinforcing our commitment to eco-consciousness and resourcefulness. The space was designed for flexibility, with movable elements that allow us to adapt the environment for each event and program.

Located in the ITP - Innovation and Training Park in Prizren, Autostrada Hangar is a true center for creation, with state-of-the-art production facilities for wood, metal, and textile work. It's a space where collaboration and creativity thrive, providing artists with the tools to bring their work to life and share it with the world.

In 2024, we expanded further with the opening of a second Hangar, offering additional production space, an open theater, and artist residencies. This expansion deepened our commitment to artists and increased opportunities for the public to engage with the creative process.

During the Biennale, Autostrada Hangar serves as the central hub for public programs, offering visitors the chance to engage directly with art through guided tours, performances, and workshops. These programs invite you to connect, reflect, and experience art in new ways.

As we celebrate the 10th anniversary of Autostrada Biennale, we invite you to explore a retrospective exhibition that reflects on our journey and the transformative power of art in our lives and communities.

Autostrada Hangar is not just an exhibition space; it's a place to pause, connect, and reflect. Whether enjoying a meal at our vegetarian kitchen, sipping coffee in our café, exploring local creations in our shop, or delving into contemporary art literature in our library, we offer space for everyone. Open to all, it's where art and people come together to foster meaningful conversations and continue the journey.

Welcome to Autostrada Hangar, where contemporary art meets the everyday.

(A L B) Autostrada Hangar është rezultat i vizionit, rrugëtimit dhe përkushtimit tonë për ta bërë artin bashkëkohor të qasshëm për të gjithë. Autostrada Biennale, e themeluar në vitin 2014 nga Leutrim Fishekqiu, Vatra Abrashi dhe Bariş Karamuço, lindi nga dëshira për të krijuar një hapësirë ku arti të mund të bashkëjetojë me jetën e përditshme dhe të flasë me njerëzit në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në vitin 2017, realizuam edicionin e parë të Bienales në Prizren – një qytet pa galeri arti dhe me pak qasje në artin bashkëkohor. Ajo që nisi si një ide e guximshme u shndërrua shpejt në një pjesë të rëndësishme të jetës kulturore të rajonit, duke krijuar një platformë ku artistë nga e mbarë bota lidhen me komunitetin lokal dhe ku arti bëhet i përbashkët.

Me rritjen e Bienales, u bë e nevojshme krijimi i një hapësire të përhershme për të punuar, bashkëpunuar dhe zhvilluar programe gjatë gjithë vitit. Gjatë viteve 2020–2021, transformuam një ish-hangar ushtarak të KFOR-it gjerman në Autostrada Hangar – Qendër për Art Bashkëkohor: një vend ku ekspozitat, punëtoritë, performancat dhe programet publike ndërtojnë ura me komunitetin.

Qëndrueshmëria është pjesë thelbësore e misionit tonë. Gjysma e materialeve të përdorura për ndërtimin e të dy Hangarëve janë ricikluar nga edicionet e kaluara të Bienales, si shenjë e përkushtimit tonë ndaj ambientit dhe përdorimit të kujdesshëm të burimeve. Hapësira është projektuar për të qenë fleksibile – me elemente të lëvizshme që përshtaten sipas çdo aktiviteti.

E vendosur brenda ITP – Parkut të Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren, Autostrada Hangar është një qendër e vërtetë krijimi. Ajo ofron pajisje moderne për punë me dru, metal dhe tekstil, duke i dhënë artistëve mundësinë të krijojnë dhe të ndajnë veprat e tyre me publikun.


Në vitin 2024, u zgjeruam me hapjen e Hangarit të dytë, duke shtuar hapësira të reja prodhimi, një teatër të hapur dhe ambiente për rezidenca artistike. Ky zgjerim forcoi përkushtimin tonë ndaj artistëve dhe krijoi më shumë mundësi për publikun që të përfshihet në procesin krijues.


Gjatë Bienales, Autostrada Hangar shërben si qendra kryesore e programeve publike, ku vizitorët mund të përjetojnë artin përmes turneve të udhëhequra, performancave dhe punëtorive. Këto programe ofrojnë hapësirë për lidhje, reflektim dhe përvoja të reja.

Në shënim të 10-vjetorit të Autostrada Biennale, ju ftojmë të vizitoni një ekspozitë retrospektive që reflekton mbi rrugëtimin tonë dhe fuqinë transformuese të artit në jetën dhe komunitetin tonë.

Autostrada Hangar nuk është vetëm një hapësirë ekspozimi – është një vend për të ndalur, për t'u lidhur dhe për të reflektuar. Qoftë duke shijuar një vakt në kuzhinën tonë vegjetariane, një kafe në kafene, duke eksploruar krijime lokale në dyqan apo duke lexuar në bibliotekën tonë të artit bashkëkohor – kjo është një hapësirë për të gjithë. E hapur çdo ditë, është vendi ku arti dhe njerëzit takohen për të nisur biseda me kuptim dhe për të vazhduar rrugëtimin së bashku.

Mirë se vini në Autostrada Hangar – aty ku arti bashkëkohor takohet me jetën e përditshme.







ARTISTS IN ITP ARTISTËT NË ITP:

TAMARA GRČIĆ
AYŞE ERKMEN
HASSAN KHAN
ARMEND NIMANI
BRILANT MILAZIMI
RIYANE NEUENSCHWANDER
ELENA NARBUTAITE
LOIS WEINBERGER
NATHAN COLEY
SILVA AGOSTINI

(ENG) Hangars 3, 9, and 10 – along with public spaces throughout the Innovation and Training Park (ITP) Prizren – have been transformed into exhibition venues for the 5th edition of Autostrada Biennale. Hangars, once located on the outskirts of Prizren, are now part of the city's dynamic Innovation and Training Park. In the early 1900s, the site served as a camp for Ottoman soldiers, later housing Yugoslav military forces. After the Kosovo War in the late 1990s, the area became a base for the German Bundeswehr, remaining so until Kosovo's declaration of independence in 2008, when a gradual process of demilitarization began.

Today, the site has become a thriving hub for innovation and business. Autostrada Biennale is part of this growing ecosystem and was the first organization to transform two of the Hangars into cultural spaces—now operating year-round as a Center for Contemporary Art. These monumental hangars are open to the public every day, hosting exhibitions, educational programs, public events, and artist residencies. This latest expansion, taking place during the fifth edition of Autostrada Biennale and made possible through an ongoing partnership with ITP Prizren, features a wide range of newly commissioned and site-specific works—including installations, paintings, performances, and photography. By extending the Biennale into these distinctive spaces, the program invites audiences to experience contemporary art in a new and meaningful context.

Tamara Grčić (b. 1964) lives and works in Frankfurt.

Ayşe Erkmen (b. 1949) lives and works in Istanbul and Berlin.

Hassan Khan (b. 1975) lives and works in Berlin and Cairo.

Armend Nimani (b. 1986) lives and works in Prishtina.

Brilant Milazimi (b. 1994) lives and works in Gjilan.

Rivane Neuenschwander (b. 1967) lives and works in São Paulo.

Elena Narbutaitė (b. 1984) lives and works in Vilnius.

Lois Weinberger (b. 1947–d. 2020) lived and worked in Vienna and Gars am Kamp.

Nathan Coley (b. 1967) lives and works in Glasgow.

Silva Agostini (b. 1979) lives and works in Berlin.

(A L B) Hangarët 3, 9 dhe 10 – së bashku me hapësira publike brenda Parkut të Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren – janë shndërruar në hapësira ekspozuese për edicionin e 5-të të Autostrada Biennale. Hangarët, dikur të vendosura në periferi të Prizrenit, tashmë janë pjesë e Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit – një hapësirë dinamike e qytetit. Në fillim të viteve 1900, ka shërbyer si kamp për ushtarët e Perandorisë Osmane, për të strehuar më pas personel ushtarak jugosllav. Pas luftës së Kosovës në fund të viteve 1990, zona u shndërrua në bazë të ushtrisë gjermane (Bundeswehr), duke qëndruar e tillë deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, kur nisi një proces gradual i demilitarizimit.

Sot, kjo zonë është shndërruar në një qendër të gjallë të inovacionit dhe zhvillimit. Autostrada Biennale është pjesë e këtij ekosistemi në rritje dhe ishte organizata e parë që e transformoi dy nga Hangarët në hapësira kulturore – që tani funksionon gjatë gjithë vitit si Qendër për Art Bashkëkohor, duke ofruar ekspozita, programe edukative, ngjarje publike dhe rezidenca për artistë.

Zgjerimi i bashkëpunimit gjatë edicionit të pestë të Autostrada Biennale, i mundësuar nga partneriteti i vazhdueshëm me ITP Prizren, sjell një gamë të gjerë veprash të reja të krijuara posaçërisht për këto hapësira – përfshirë instalacione, piktura, performanca dhe fotografi. Duke e shtrirë Bienalen në këto hapësira të veçanta, programi fton publikun të përjetojë artin bashkëkohor në një kontekst të ri dhe domethënës.

Tamara Grčić (lindur më 1964) jeton dhe punon në Frankfurt.

Ayşe Erkmen (lindur më 1949) jeton dhe punon në Stamboll dhe Berlin.

Hassan Khan (lindur më 1975) jeton dhe punon Berlin dhe Kajro.

Armend Nimani (lindur më 1986) jeton dhe punon në Prishtinë.

Brilant Milazimi (lindur më 1994) jeton dhe punon në Gjilan.

Rivane Neuenschwander (lindur më 1967) jeton dhe punon në São Paulo.

Elena Narbutaitė (lindur më 1984) jeton dhe punon në Vilnius.

Lois Weinberger (lindur më 1947 – vdekur më 2020) jetonte dhe punonte në Vjenë dhe Gars am Kamp.

Nathan Coley (lindur më 1967) jeton dhe punon në Glasgow.

Silva Agostini (lindur më 1979) jeton dhe punon në Berlin.

HANGAR 3



H3-2
Ayşe
Erkmen

H3-1
Tamara Grčić

(ENG) For the 5th edition of the Autostrada Biennale, projects like Tamara Grčić's installation take full advantage of the expansive hangar space. Her work features 11,611 glass bottles, withdrawn from industrial use and transformed into performers. These bottles, arranged in hues of green and brown, respond to the sunlight and the movement of the wind, spilling across the hangar floor like a shimmering, living stream. Freed from their original function, the bottles partake in a transient choreography, shaped by light, air, and sound. Ultimately, they return to the production cycle to be fully recycled, completing a circular journey from industrial creation to artistic expression and back again.

Ayşe Erkmen's project *Left Overs 2* explores the site-specific potential of biennials by repurposing sculptural wooden panels sourced from local workshops specializing in wood, metal, and textiles. These leftover materials, with their distinctive shapes, caught Erkmen's attention and were reimagined within the grid structure of a former military hangar—now transformed into an exhibition space. To enhance their presence and situate them within a contemporary context, Erkmen applied the Pantone Colors of 2024—an annually selected, globally recognized palette. In this way, the work creates a dialogue between past and present, material and meaning, tracing a shift from military history to contemporary artistic expression.


(ALB) Për edicionin e 5-të të Autostrada Biennale, projekte si instalacioni i Tamara Grčić përfitojnë në tërësi nga hapësira e gjerë e hangarit. Puna e saj përfshin 11,611 shishe qelqi, të tërhequra nga përdorimi industrial dhe të transformuara në interpretuese. Këto shishe, të renditura në nuanca të gjelbërta dhe kafe, reagojnë ndaj rrezeve të diellit dhe lëvizjes së erës, duke u shpërndarë në dyshtimin e hangarit si një lumë që shkëlqen dhe merr jetë. Të çliuara nga funksioni i tyre fillestar, shishet marrin pjesë në një koreografi të përkohshme, të formuar nga drita, ajri dhe tingulli. Në fund, ato kthehen në ciklin e prodhimit për t'u ricikluar plotësisht, duke



përfunduar kështu një udhëtim rrethor nga krijimi industrial te shprehja artistike dhe përsëri mbrapsht.

Projekti i Ayşe Erkmen me titullin *Left Overs 2* (Mbetjet 2) eksploron potencialin specifik për hapësirën të bienaleve duke ripërdorur panelet e drunjtja skulpturore të marra nga punishtet lokale që përqendrohen te zdrukthëtaria, përpunimi i metaleve dhe i tekstileve. Këto materiale të mbetura, me format e tyre të dallueshme, kanë cytur vëmendjen e Erkmen dhe janë ripërfytyruar përbrenda strukturës kuti-kuti të një hangari të dikurshëm ushtarak, i cili tanimë është shndërruar në një hapësirë ekspozimi. Për të lartësuar praninë e tyre dhe për t'i vendosur në një kontekst bashkëkohor, Erken ka aplikuar Ngjyrat Pantone të vitit 2024, një gamë ngjyrash e njohur botërisht. Në këtë mënyrë, vepra krijon një dialog mes së kaluarës dhe të tashmes, mes materialit dhe domethënies, duke ndjekur shndërrimin nga historia ushtarake deri tek shprehja artistike.

HANGAR 9



Address: Rruga Ukë
Bytyqi, ITP Building
No. 09

(ENG) Hassan Khan's *The Infinite Hip-Hop Song* (2019) is an algorithmic music installation that generates unique continuously changing hip-hop tracks. Created in close technical collaboration with computer music designer and composer Olivier Pasquet, it uses a system that combines 351 lyrical lines delivered by eleven rappers and a vast array of beats, bass lines and melodies - though driven by a system of probabilities all these elements are authored by the artist to produce an ever-changing song. Khan explores hip-hop's ability to create meaning in contemporary times using machine logic as a compositional tool. The work challenges traditional ideas of authorship and repetition, offering a generative engagement with cultural transformations.

(ALB) *The Infinite Hip-Hop Song* (2019) i Hassan Khan është një instalacion muzikor algoritmik që krijon në mënyrë të vazhdueshme këngë unike të hip-hop-it. I krijuar në bashkëpunim të ngushtë teknik me dizajnerin dhe kompozitorin e muzikës kompjuterike Olivier Pasquet, ky sistem kombinon 351 rreshta lirike të interpretuara nga njëmbëdhjetë reperë dhe një shumëllojshmëri rrahjesh, vijash bas dhe melodish – megjithëse i udhëhequr nga një sistem probabilitetesh, të gjitha elementet janë krijuar nga vetë artisti për të prodhuar një këngë që ndryshon vazhdimisht. Khan eksploron aftësinë e hip-hop-it për të krijuar kuptim në kohët bashkëkohore, duke përdorur logjikën e makinës si një mjet kompozimi. Vepra sfidon idetë tradicionale të autorësisë dhe përsëritjes, duke ofruar një angazhim gjenerues me transformimet kulturore.

HANGAR 10



Address: Rruga Ukë
Bytyqi, ITP Building
No. 10

(ENG) Armend Nimani's practice as a photojournalist centers on documenting the human condition, capturing the complexities of cultural identity, migration, and loss. Through his lens, he reveals moments of community and tradition, such as the Circumcision Festival in Donje Lubinje, where ancient customs blend with modern practices. His *Refugees* series poignantly depicts the desperation and resilience of those fleeing conflict, while *Missing Persons* gives voice to families still searching for loved ones lost in the Kosovo War. Nimani's work combines intimate storytelling with social and political context, reflecting on the enduring scars of conflict.

Brilant Milazimi's paintings exist in a shadowy underworld, carving out space for reflections on memory, trauma, hope, and freedom. The Gjilan-based artist's work is filled with toothy, tentacular connections and surreal creatures. Milazimi's symbolic imagery subtly hints at the tensions beneath the surface of everyday experiences. As part of his contribution to the 5th edition of the Autostrada Biennale, Milazimi spent a month at the Autostrada Hangar in Prizren, where he created two large-scale works. These pieces, developed in close dialogue with the site's architectural potential and social context, will be unveiled at the Biennale in 2025.

Rivane Neuenschwander's *Eu desejo o seu desejo* (I wish your wish) draws inspiration from the tradition at São Salvador's church in Bahia, Brazil, where visitors tie colored ribbons to their wrists while making wishes, believing that the wishes will come true when the ribbons eventually break. In this installation, Neuenschwander prints the wishes of forty people onto thousands of ribbons, which are then hung for visitors to choose and wear, adopting someone else's desire. Visitors are also invited to write their own wishes on slips of paper and place them in the wall, allowing the work to grow and evolve with each new interaction. Through this process, Neuenschwander invites the audience to become active participants, constantly weaving new hopes and aspirations into the installation.

"Tracing Elena Narbutaitė's engagement with lasers and LED's, Laser and LED are two distinct forms of light, each with their own rhythm and resonance. A laser's beam is a sharpened line, its waves perfectly in phase – a coherence that gives it the power to cut, measure and guide. The LED, by contrast, is an unfolding glow, its photons out of step, its wavelengths blending into a spectrum that shifts and scatters. One involves focused precision, the other a dispersed field of color. Both are familiar from situations as diverse as the vibrant pulse of a party, the lethal targeting of warfare, the beam that holds an electronic door ajar, or the silent transfer of data. Narbutaitė reconfigures these ubiquitous associations, reimagining the cold accuracy of industrial lasers and the ambient shifting hues of LEDs into something unbound."


(ALB) Praktika e Armend Nimanit si fotoreporter përqendrohet në dokumentimin e gjendjes njerëzore, duke kapur kompleksitetin e identitetit kulturor, migrimit dhe humbjes. Përmes objektivit të tij, ai zbulon momente të komunitetit dhe traditës, siç është Festivali i Synetisë në Donje Lubinjë, ku zakonet e lashta ndërthuren me praktikat moderne. Seria e tij "Refugjatët" paraqet me ndjeshmëri dëshpërimin dhe qëndrueshmërinë e atyre që ikin nga konfliktet, ndërsa "Personat e zhdukur" u jep zë familjeve që ende kërkojnë të afërmit e humbur gjatë luftës në Kosovë. Puna e Nimanit ndërthur tregimin intim me kontekstin shoqëror e politik, duke reflektuar mbi plagët e qëndrueshme të konfliktit.


Pikturat e Brilant Milazimit ekzistojnë në një botë hijeje, duke hapur hapësirë për refleksime mbi kujtesën, traumën, shpresën dhe lirinë. Puna e artistit nga Gjilani është e mbushur me lidhje të dhëmbëzuara, tentakula dhe krijesa surreale. Imagjinata simbolike e Milazimit nënkupton në mënyrë të heshtur tensionet që qëndrojnë në sipërfaqen e përditshmërisë. Si pjesë e kontributit të tij për edicionin e 5-të të Autostrada Bienales, Milazimi kaloi një muaj në Autostrada Hangar në Prizren, ku krijoi dy vepra në përmasa të mëdha.

Këto vepra, të zhvilluara në dialog të ngushtë me potencialin arkitektonik dhe kontekstin shoqëror të vendit, do të prezantohen në Bienalen e vitit 2025.

Eu desejo o seu desejo (Unë dëshiroj dëshirën tënde) nga Rivane Neuenschwander frymëzohet nga tradita në kishën São Salvador në Bahia, Brazil, ku vizitorët lidhin fjongo me ngjyra në kyçet e duarve duke shprehur një dëshirë, me besimin se ajo do të realizohet kur fjongoja të këputet vetvetiu. Në këtë instalacion, Neuenschwander shtyp dëshirat e dyzet personave mbi mijëra fjongo, të cilat më pas varen që vizitorët t'i zgjedhin dhe t'i mbajnë, duke adoptuar dëshirën e dikujt tjetër. Vizitorët ftohen gjithashtu të shkruajnë dëshirat e tyre mbi copëza letre dhe t'i vendosin në mur, duke i dhënë veprës mundësinë të rritet e të ndryshojë me çdo ndërveprim të ri. Përmes këtij procesi, Neuenschwander i fton vizitorët të bëhen pjesëmarrës aktivë, duke thurur vazhdimisht shpresa dhe aspirata të reja në instalacion.

“Duke ndjekur përfshirjen e Elena Narbutaitë me lazerët dhe dritat LED, *Laser* dhe *LED* janë dy forma të dallueshme drite, secila me ritmin dhe rezonancën e vet. Rrezja e lazerit është një vijë e mprehtë, valët e saj janë në fazë të përsosur – një koherencë që i jep asaj fuqinë për të prerë, matur dhe udhëhequr. Ndërkohë, LED është një ndriçim që shpalolet, fotonet e tij nuk janë në sinkron, gjatësitë e valëve ndërthuren në një spektër që ndryshon e shpërndalet. Njëra përfaqëson saktësinë e fokusuar, tjetra një fushë të përhapur ngjyrash. Të dyja janë të zakonshme në situata të ndryshme – nga ritmi i gjallë i një feste, te shënjestrimi vdekjeprurës në luftë, nga rrezja që mban hapur një derë elektronike, te transferimi i heshtur i të dhënave. Narbutaitë i rikonfiguron këto lidhje të njohura, duke rimenduar saktësinë e ftohtë të lazerëve industrialë dhe nuancat ambientale të LED-ëve në diçka të pakufishme.”





ITP OUTDOOR HAPËSIRAT E JASHTME NË ITP



Address: Rruga Ukë
Bytyqi, ITP Prizren

(ENG) The evolving nature of artistic practices is vividly captured in the work of Lois Weinberger, who, in 1994, described a process of organic transformation: “On a concrete surface, plastic buckets filled with soil from the open ground are placed. Since seeds are already present in the soil, the work will develop on its own. Over time, the containers will only appear as brittle, colorless plastic fragments on the overgrown surface. These too will dissolve, and only the blossoms will still recall the initial colorfulness. Later, my work will no longer be perceived; the author has vanished.”

This idea of impermanence and transformation aligns with Nathan Coley’s *I Don’t Have Another Land* (2022), which draws inspiration from graffiti he encountered in Jerusalem. Acknowledging the complexity of the contexts his pieces inhabit, Coley reflects on the power of language in shaping viewers’ perceptions. Each person brings their own values and beliefs to the interpretation of the words, which are further shaped by their surroundings. Installed in the Prizren Innovation and Training Park—a site rich in history, from its origins as an Ottoman military camp to its later use as a German Bundeswehr base—the work connects to the park’s reinvention as a dynamic space for artistic and cultural exchange.

Silva Agostini’s work examines the fluid interplay between historical layers and contemporary expressions, emphasizing the evolving nature of existence. For the 5th edition of the Autostrada Biennale, Agostini will adapt her performance *Music Requisites*, temporarily blocking a street in ITP. In this piece, the third act of Wagner’s *Die Feen* (The Fairies) will emanate from parked cars, transforming these industrial objects into vessels of 19th-century symbolism. The music transports us into a realm of magic, conflict, and myth, reverberating through the urban landscape.

(ALB) Natyra në zhvillim e praktikave artistike shfaqet me qartësi në veprën e Lois Weinberger, i cili në vitin 1994 përshkroi një proces transformimi organik: “Mbi një sipërfaqe betoni, vendosen kova plastike të mbushura me dhe nga toka e hapur. Meqë fara ndodhen tashmë në dhe, vepra do të zhvillohet vetvetiu. Me kalimin e kohës, kontejnerët do të duken vetëm si fragmente plastike të brishta dhe pa ngjyrë mbi sipërfaqen e tejmbushur. Edhe ato do të shpërbëhen, dhe vetëm lulet do të kujtojnë ngjyrat e fillimit. Më vonë, vepra ime nuk do të perceptohet më; autori është zhdukur.”

Kjo ide e përkohshmërisë dhe transformimit lidhet me veprën *I Don’t Have Another Land* (2022) të Nathan Coley, e frymëzuar nga një grafit që ai pa në Jerusalem. Duke e njohur kompleksitetin e konteksteve që veprat e tij zënë, Coley reflekton mbi fuqinë e gjuhës për të formuar perceptimet e shikuesve. Secili sjell vlerat dhe besimet e veta në interpretimin e fjalëve, të cilat formësohen më tej nga ambienti përreth. E instaluar në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren – një hapësirë me histori të pasur, nga origjina si kamp ushtarak osman të përdorimi më vonë nga Bundeswehri gjerman – vepra lidhet me rilindjen e parkut si një hapësirë dinamike për shkëmbim artistik dhe kulturor.

Vepra e Silva Agostinit shqyrton ndërveprimin e rrjedhshëm mes shtresave historike dhe shprehjeve bashkëkohore, duke theksuar natyrën në ndryshim të ekzistencës. Për edicionin e 5-të të Autostrada Bienales, Agostini do të përshtasë performancën e saj *Music Requisites*, duke bllokuar përkohësisht një rrugë në ITP. Në këtë pjesë, akti i tretë i operës *Die Feen* (Përrallat) të Wagnerit do të dëgjohet nga veturat e parkuara, duke i shndërruar këto objekte industriale në bartës të simbolizmit të shekullit XIX. Muzika na transporton në një botë magjie, konflikti dhe miti, duke rezonuar nëpër peizazhin urban.

MAP OF HISTORICAL ZONE HARTA E ZONËS HISTORIKE



SEH - Shani Efendi House

Shtëpia e Shani Efendiut
Simon Shiroka
Brilant Milazimi
Robert Gabris
Anita Muçolli
Blerta Hashani
Alije Vokshi

GMPH - Gazi Mehmed

Pasha Hammam / Hamami
i Gazi Mehmed Pashës
Doruntina Kastrati
Anita Muçolli
Stephanie Rizaj

DFH - Dorambari Family House

Shtëpia e Familjes Dorambari
Laurent Mareschal
Nika Špan
Edin Zenun
David Fesl
Small But Dangers


**Archaeological Museum and
Clock Tower** / Muzeu Arkeologjik
dhe Sahatkulla
Vadim Fishkin

***MB - Performance Venue in City
Centre: Marin Barleti Street and
School of Music**

*Hapësira për Përfomancë në
Qendër të Qytetit: Rruga Marin
Barleti dhe Shkolla e Muzikës
Tao G. Vrhovec Sambolec

HISTORICAL ZONE ZONA HISTORIKE

SHANI EFENDI HOUSE SHTËPIA E SHANI EFENDIUT



Address: Rruga
Farkëtarët

ARTISTS ARTISTËT:

SIMON SHIROKA
BRILANT MILAZIMI
ROBERT GABRIS
ANITA MUÇOLLI
BLERTA HASHANI
ALIJE VOKSHI

(ENG) A short walk from Prizren's central marketplace, the Shani Efendi House continues this exploration of embodied practice. Built in the 1930s as a private residence, it later became a site for political and social gatherings during the Yugoslav period.

On the first floor, the mixed-media paintings and sculptures of Prizren-born artist Simon Shiroka deepen the exhibition's connection to local artisanal practices and mythologies. Steeped in the city's craft traditions, Shiroka's work merges silversmithing techniques with contemporary art, rendering intricate scenes based on dreams, complex filigree motifs, Kosovar symbology, and more.

Brilant Milazimi's delicate watercolors, on view at the Shani Efendi House, continue his exploration of memory, trauma, and the subconscious. Through surreal creatures and fragmented forms, Milazimi evokes quiet tension and psychological transformation. These intimate works, presented in the historic setting of the house, offer a striking counterpoint to the large-scale paintings he is currently showing at the Hangar for the 5th edition of the Autostrada Biennale.

Meanwhile, Robert Gabris's large-scale drawing *The Garden of Catastrophy* (2024) seeks, in his words, not to "aestheticize the concept of dying,"¹ but to engage with flaw, failure, and imminent disaster. Gabris's detailed pencil work—depicting interrelated beings—functions, as he explains, as "an integral part of retelling historical oppression and pain, embodying the idea of existence afterward."²

On the ground floor, intensifying the atmosphere, Anita Muçolli's ceramic interventions reference Kosovar fables, family narratives, and childhood memories. Her sleek, dark-patinated forms animate the space, evoking horror-genre imagery of the monstrous and reminding viewers that human animals are not the only beings present here.

Blerta Hashani's painting practice is deeply rooted in the landscape of Mirash, her birthplace in southern Kosovo, yet it expands to engage with broader rural environments. In an era when rural life is often romanticized or dismissed, Hashani offers a grounded reflection on tradition. Her work juxtaposes expressive depictions of animals and landscapes with abstract, intuitive forms, developing a poetic visual language that speaks to the complexities of place, belonging, and the evolving realities of the rural world.

Further exploring memory and identity from a personal perspective, Alije Vokshi's expressive paintings navigate the space between figuration and abstraction. Drawing from lived experience and Kosovo's sociopolitical history, her work delves into identity, memory, and resilience—with a particular focus on the emotional lives of women. Through gestural brushwork and allusions to Albanian culture, Vokshi, a pioneering female artist, employs painting as a potent act of expression, resistance, and remembrance.

Simon Shiroka (b. 1927–d. 1994) lived and worked in Prishtina.
Brilant Milazimi (b. 1994) lives and works in Gjiilan.
Robert Gabris (b. 1986) lives and works in Vienna.

Anita Muçolli (b. 1993) lives and works in Basel.
Blerta Hashani (b. 1997) lives and works in Mirash.
Alije Vokshi (b. 1945–d. 2022) lived and worked in Prishtina.

(A L B) Disa minuta me këmbë nga sheshi qendror i Prizrenit gjendet Shtëpia e Shani Efendiut, ku vazhdohet ky eksplorim i praktikës së trupëzimit. E ndërtuar si rezidencë private në vitet 1930, kjo shtëpi është shfrytëzuar më vonë për grumbullime politike dhe shoqërore gjatë periudhës jugosllave.

Në katin e parë, pikturat dhe skulpturat e stileve të ndryshme nga nga artisti prizrenas Simon Shiroka thellojnë lidhjen e ekspozitës me praktikën artizanale dhe mitologjinë vendëse. Duke qenë e zhytur në historinë e zejeve të qytetit, vepra e Shirokës bashkon qasjet tradicionale në mjeshtërinë e argjendarisë dhe artin bashkëkohor përmes krijimit të skenave të ndërlikuara që kanë për bazë ëndrrat, motivet komplekse të filigraneve, simbologjinë e Kosovës dhe të tjera.

Akuarelet delikate të Brilant Milazimit, të cilat mund të soditen në Shtëpinë e Shani Efendiut, vazhdojnë eksplorimin e tij të kujtesës, traumës dhe nënvetëdijes. Përmes krijesave surreale dhe formave të copëzuara, Milazimi ndjell një tension të heshtur dhe një transformim psikologjik. Këto vepra intime, të shfaqura në prapavijën historike të shtëpisë, ofrojnë një kontrast të madh në krahasim me pikturat e përmasave të mëdha që tani po i ekspozon në Hangar për edicionin e 5-të të Autostrada Biennale.

Ndërkohë, vizatimi i madh i Robert Gabris-it me titullin *The Garden of Catastrophy* ("Kopshti i katastrofës", 2024) mësyn, sipas tij, jo "të estetizojë konceptin e vdekjes"³, por të bashkëpunojë me të metën, me dështimin dhe me katastrofën e afërt. Linjat e ndërpleksura të Gabris-it që përshkruajnë qenie të ndërlidhura janë "pjesë thelbësore e ritregimit të shtypjes dhe dhimbjes historike, duke mishëruar idenë e ekzistencës së pastajme".⁴

Në katin përdhës përforcohet kjo atmosferë përmes intervenimeve qeramike të Anita Muçollit, të cilat u referohen përrallave, rrëfimeve familjare dhe kujtimeve fëmijërore nga Kosova. Trajatat e saj, me kaltërinë të errëtë e të lëmuara, mbushin hapësirën dhe sjellin ndërmend përshkrimet e zhanrit horror të së përbindshmes, duke i kujtuar sojtit njerëzor se nuk janë banorët e vetëm të kësaj hapësire.



Praktika pikturore e Blerta Hashanit është thellësisht e rrënjësuar në peizazhin e Mirashit, vendlindjes së saj në jug të Kosovës, por njëkohësisht shtrihet edhe përtej tij, duke u ndërtuar me mjedise më të gjera rurale. Në një epokë kur jeta fshatare shpesh romantizohet ose shpërfillet, Hashani ofron një pasqym me themel tek tradita. Vepra e saj përfaqëson përfytyrimet ekspresive të kafshëve dhe peizazhet me forma abstrakte e intuitive, duke zhvilluar një gjuhë poetike pamore që flet për kompleksitetet e vendit, përkatësisë dhe realiteteve në ndryshim të botës rurale.


Duke eksploruar më tej kujtesën dhe identitetin nga një perspektivë personale, pikturat ekspresive të Alije Vokshit lëvizin në hapësirën ndërmjet figuracionit dhe abstraksionit. Me frymëzim nga përjetimet personale dhe historia shoqërore-politike e Kosovës, vepra e saj trajton identitetin, kujtesën dhe qëndrueshmërinë—me theks të veçantë tek jeta emocionale e grave. Me brushë bujare dhe aluzione ndaj kulturës shqiptare, Vokshi, një artiste pioniere, e përdor pikturën si akt të fuqishëm shprehjeje, rezistence dhe kujtese.


Simon Shiroka (Ind. 1927–vd. 1994) jetoi dhe veprroi në Prishtinë.
Brilant Milazimi (b. 1994) jeton dhe vepron në Gjilan
Robert Gabris (Ind. 1986) jeton dhe vepron në Vjenë.
Anita Muçolli (Ind. 1993) jeton dhe vepron Bazel.
Blerta Hashani (b. 1997) jeton dhe vepron në Mirash.
Alije Vokshi (b. 1945–d. 2022) jetoi dhe punoi në Prishtinë.

1 Robert Gabris, "The Garden Of Catastrophy", 2024.
Online: <https://robertgabis.com/the-garden-of-catastrophy.html>.
2 *Ibid.*

GAZI MEHMED PASHA HAMMAM HAMAMI I GAZI MEHMED PASHES







ARTISTS ARTISTËT: DORUNTINA KASTRATI STEPHANIE RIZAJ ANITA MUÇOLLI

(ENG) Gazi Mehmed Pasha Hammam, built in the 1570s and notable for its twenty domes—makes it one of the largest of its kind in the Balkans. Although partially restored in the 1970s, the site was later abandoned. Over the past fifteen years, renewed restoration efforts have enabled its limited use for cultural and educational purposes. As of 2024, the first phase of refurbishment has been completed, granting access to major sections of the building. Blurring the line between artifact and replica within its vaulted chambers, the historic bathhouse invites visitors to become active participants in the act of interpretation—a theme explored in Doruntina Kastrati's work. Often taking sculptural, infrastructural, and filmic forms, Kastrati's practice foregrounds fragmented bodies, labor conditions, and the precarity of everyday life. In this context, her intervention marks a vital artistic dialogue with the space, contributing a fresh layer to its evolving narrative.

In a similar vein, Stephanie Rizaj's multidisciplinary practice delves into themes of class, identity, and power structures, exploring collective belonging through sculpture, installation, video, and textiles. Her examination of fragility and resilience resonates with the Hammam's transformation. For the 5th Autostrada Biennale, Rizaj presents a new large-scale installation made from clothing labels—fragments of mass-produced garments—carefully transformed through a slow, manual process into a powerful commentary on labor, value, and the untold stories of daily life. In doing so,

she deepens the conversation around human existence and labor within the context of the Hammam's evolving identity.

Turning toward the site's eroded symbolic function, Anita Muçolli presents a site-specific installation reflecting on its transformation from a place of communal purification to a silent architectural shell. By engaging with the structure as both witness and remnant, Muçolli evokes the human body as a fossilized, deformed trace—caught between memory and speculation. This quiet meditation on absence and transformation not only explores the fading of cultural rituals but also highlights the lingering presence they continue to exert on collective memory. Together, these three artists bring a compelling mix of presence, absence, and transformation to the Hammam, engaging in a collective act of reimagining its place in contemporary consciousness.

Doruntina Kastrati (b. 1991) lives and works in Prishtina.

Stephanie Rizaj (b. 1989) lives and works in Brussels and Vienna.

Anita Muçolli (b. 1993) lives and works in Basel.

(A L B) Hamami i Gazi Mehmed Pashës, është ndër-
tuar rreth vitit 1570. Me njëzet kupolat e tij, ai shquhet si një
ndër hamamet më të mëdha në tërë Ballkanin. Ky monument
është meremetuar pjesërisht në vitet 1970, por mandej është
braktisur. Në pesëmbëdhjetë vitet e fundit kanë rifilluar pro-
jektet për meremetimin e tij, gjë që ka lejuar shfrytëzimin e
pjesëshëm të ndërtesës për qëllime edukative dhe kulturore.
Në vitin 2024 është përmbyllur faza e parë e rregullimit dhe
është mundësuar përdorimi i seksioneve të rëndësishme
të ndërtesës. Duke megjulluar kufirin mes artefaktit dhe të
riprodhuarës brenda kthinave të saj me kube, kjo banjë his-
torike i fton vizitorët të bëhen pjesëmarrës aktivë në aktin
e interpretimit, gjë që ekspolrohet në veprën e Doruntina
Kastratit. Praktika e saj, e cila shpesh merr trajta skulpturore,
infrastrukturore dhe filmike, hedh dritë mbi trupat e fragmen-
tuar, kushtet e punës dhe pasigurisë së jetës së përditshme.

Në këtë kontekst, intervenimi i saj shënon një dialog jetik
artistik përbrenda hapësirës, duke ia shtuar një shtresë të
freskët narrativës së saj në evoluim e sipër.

Në këtë drejtim, praktika multidisiplinare e Stephanie
Rizaj trajton temat e klasës, identitetit dhe strukturave të
pushtetit, duke eksploruar përkatësinë kolektive përmes
skulpturës, instalacionit, videos dhe tekstileve. Hulumtimi
i saj mbi brishtësinë dhe qëndrueshmërinë përputhet me
transformimin e Hamamit. Për edicionin e 5-të të Autostrada
Biennale, Rizaj paraqet një instalacion të ri në shkallë të
madhe të krijuar nga etiketat e rrobave—pra, fragmente të
veshjeve të prodhuara në masë—të cilat, me kujdes dhe
përmes një procesi të ngadalë dhe manual, janë shndërruar
në një përsiatje të fuqishëm mbi punën, vlerën dhe rrëfimet e
pathëna të jetës së përditshme. Në këtë mënyrë, ajo thëllon
diskutimin mbi ekzistencën njerëzore dhe punën brenda kon-
tekstit të identitetit në ndryshim të Hamamit.



Për t'iu kthyer funksionit të gërryer simbolik të hapësirës,
Anita Muçolli paraqet një instalacion specifik për hapësirën
që reflekton mbi transformimin e saj nga një vend i pastrimit
të përbashkët në një lëvizje arkitekturore të heshtur. Duke
e trajtuar strukturën njëkohësisht si dëshmitare dhe si mbetje,
Muçolli parashtrohet trupin njerëzor si gjurmë të fosilizuar
e të shformuar, i cili zë vend në kapërcyellin mes kujtesës
dhe spekulimit. Ky meditim i qetë mbi mungesën dhe trans-
formimin jo vetëm që eksploron zhdukjen e ritualeve kulturore,
por gjithashtu nxjerr në pah praninë e tyre të vazhdueshme në
kujtesën kolektive. Së bashku, këta tre artistë sjellin një përzi-
erje mbresëlënëse të pranisë, mungesës dhe transformimit në
Hamam, duke marrë pjesë në një veprim kolektiv të rikoncep-
timit të vendit të tij në ndërgjegjen bashkëkohore.

Doruntina Kastrati (Ind. 1991) jeton dhe vepron në Prishtinë.

Stephanie Rizaj (Ind. 1989) jeton dhe vepron në Vjenë dhe Bruksel.

Anita Muçolli (Ind. 1993) jeton dhe vepron në Bazel.

DORAMBARI FAMILY HOUSE SHTËPIA E FAMILJES DORAMBARI



ARTIST ARTISTËT: LAURENT MARESCHAL NIKA ŠPAN EDIN ZENUN DAVID FESI SMALL BUT DANGERS

(ENG) Dorambari Family House—opened to the public for the first time—offers an intimate, domestic setting of Ottoman-era flourishes in which to view artworks. Here, the warm wooden interiors of this historical residence bring visitors into close proximity with a number of works that engage multiple senses.

Laurent Mareschal's *Beiti* (2011)—meaning “my house” in Arabic—is a large-scale installation of mosaic tiles made from aromatic spices central to Palestinian and other Middle Eastern culinary traditions. These fragrant elements fade over time, tugging at memory in ways that are hard to articulate, while also evoking the devastation of many cultural practices in the Middle East. Around the corner from these affective odors, a knocking can be heard. Emerging from behind a door, Nika Špan's *Who is there? / Who's there?* (2010) invites the viewer to become a listener—and a participant, too, if they choose to respond to the work's central questions. Also moving through the house, Edin Zenun's small-format paintings are reminiscent of gestural choreographies.⁵ These serial works, in their fragile-looking, self-produced frames, create a predetermined score that the viewer's eyes reenact, as each composition offers a kind of explanation for the next.⁶



Tears (2015) by Small But Dangers reimagines men's cotton handkerchiefs by tautening them onto wooden frames, transforming their straight borders into wavy patterns. This subtle alteration disrupts the handkerchief's traditional "empty" whiteness, unveiling its potential to challenge the aesthetics of everyday life. The piece critiques masculinity, minimalism, and societal norms, turning the handkerchief into a fragmented vessel of memory and emotion. By filling the gaps left in the fabric, viewers are invited to reflect on identity, class, and the politics of form. This exploration of embodied practice continues inside the house with David Fesl's archive of palm-sized object assemblages. The intimate and surprising compositions of everyday elements resist easy interpretation. *Rather than supporting the meanings of objects, [Fesl] removes or redirects them... the intermingling of findings creates a new form of family or kinship.*⁷

Laurent Mareschal (b. 1975) lives and works in Paris.

Nika Špan (b. 1967) lives and works in Düsseldorf and Ljubljana.

Edin Zenun (b. 1987) lives and works in Vienna.

David Fesl (b. 1995) lives and works in Prague.

Small But Dangers (b. 1977) lives and works in Cerkno.

(A L B) Shtëpia e Familjes Dorambari —e cila hapet për publikun për herë të parë— ofron një sfond intim shtëpiak me zbukurime të periudhës osmane që shoqërojnë veprat e artistit. Këtu, interieret e ngrohta nga druri i sjellin vizitorët në afërsi të ngushtë me një varg veprash që stimulojnë një shumësi shqisash.

Vepra *Beiti* (2011)—që do të thotë "shtëpia ime" në arabisht—nga Laurent Mareschal është instalacion me pllakëza mozaiku të përbëra prej erëzash aromatike që janë thelbësore në traditat gjellëtare palestineze në veçanti dhe të Lindjes së Mesme në përgjithësi. Këto elemente erëmira zbehen me kalimin e kohës, duke cytur kujtesën në mënyra që shprehen me vështirësi, por edhe duke ua kujtuar vizitorëve shkatërrimin e shumë praktikave kulturore në Lindjen e Mesme. Në afërsi të këtyre aromave afektive degjohet një trokitje.

Prapa një dere, vepra e Nika Špan *Who is there? / Who's there?* ("Kush është aty?", 2010) i fton shikuesit të bëhet dëgjues—por edhe pjesëmarrës, në qoftë se zgjedh t'u përgjigjet pyetjeve thelbësore të veprës. Nëpër këtë shtëpi qarkullon edhe vepra Edin Zenunit, të cilat janë piktura të formatit të vogël që të kujtojnë koreografitë gjestuale. Këto punime serike me korniza të vetëprodhuara dhe me pamje të brishtë krijojnë një partiturë të paracaktuar, të cilën sytë e shikuesit e rikrijojnë meqë çdo kompozim ofron një lloj shpjegimi për atë që vjen më pas.⁸

Tears ("Lotë", 2015) nga Small But Dangers ripërftyron mindilët e pambuktë të burrave, duke i tendosur në korniza druri dhe duke i valëzuar anët e tyre të drejta. Ky ndërrim delikat prish bardhësinë tradicionale dhe "të zbrazët" të mindilit dhe kështu zbulon potencialin e tij për të sfiduar estetikën e përditshmërisë. Vepra kritikon burrërinë, minimalizmin dhe normat shoqërore, duke e shndërruar mindilin në një mbartës të kujtesës dhe emocionit. Duke i mbushur zbrazëtirat e mbetura në tekstil, shikuesit ftohen të reflektojnë mbi identitetin, klasën dhe politikat e formës. Ky eksplorim vazhdon brenda shtëpisë me grumbuj gjësendedesh të vogla nga David Fesl. Bashkëvendosja intime dhe befasuese e elementeve të përditshme u reziston interpretimeve të thjeshta. *Përkundrazi, në vend që të mbështesë domethëniet e gjësendedeve, [Fesl] i heq ose u jep kahje tjetër. [...] Ndërthurja e gjetjeve krijon një formë të re të familjes ose të farefisnisë.*⁹

Laurent Mareschal (Ind. 1975) jeton dhe vepron në Paris.

Nika Špan (Ind. 1967) jeton dhe vepron në Düsseldorf dhe Lubljanë.

Edin Zenun (Ind. 1987) jeton dhe vepron në Vjenë.

David Fesl (Ind. 1995) jeton dhe vepron në Pragë.

Small But Dangers (Ind. 1977) jeton dhe vepron në Cerkno.

5 Vanessa Joan Müller on Edin Zenun in *Unknown Familiars*, Leopold Museum, Vienna, 2024.

6 *Ibid*

7 Excerpt from a text by the artist and Zuzana Blochová, in *I Will Watch With You*, Cursor Gallery, Prague, 2024.

ARCHAEOLOGICAL MUSEUM AND THE CLOCK TOWER MUZEU ARKEOLOGJIK DHE SAATKULLA



Address: Rruga
Saraçët



AM-1
Vadim
Fishkin

AM-2
Vadim
Fishkin



ARTIST ARTIST: VADIM FISHKIN

(ENG) The Archaeological Museum and the Clock Tower are key landmarks in Prizren. Built in 1498, the Hamam of Shemsedin Ahmet Bey ceased to function by the mid-19th century, when part of its structure was replaced by the Clock Tower. Originally made of wood, the tower was later rebuilt in stone by Eshref Pasha Rrotulli. Its clock and bell, removed in 1912, remain missing to this day. After years of neglect, restoration efforts in the 1970s transformed the hamam into the Archaeological Museum of Prizren, which now houses artifacts ranging from the Neolithic to the Ottoman periods.

For this year's biennale, Vadim Fishkin's *Lighthouse* (1996) transforms the tower into a living signal. Pulsing lights—linked in real time to the artist's heartbeat, wherever he is—are transmitted via mobile technology. Having traveled to various contexts, the work now turns the site into a beacon, guiding visitors on their biennale journey.

Also on view is *Dark Times* (2019–20), presented inside the Archaeological Museum of Prizren. Time is one of the eternal questions to which Fishkin regularly returns in his art. Time, as a phenomenon, possesses the duality of being both physical and metaphysical—both an object of scientific study and a wholly ungraspable, uncontrollable force that shapes every aspect of our existence as finite beings. We view time as the most objective of norms and measure it with precision, yet our experience of it is constantly shaped by subjective impulses and moods: time feels short or long depending on the emotional state we are in.¹⁰

Vadim Fishkin (b. 1965) lives and works in Ljubljana.

(ALB) Muzeu Arkeologjik dhe Sahatkulla janë monumente kyçe të Prizrenit. I ndërtuar në vitin 1498, hamami i Shemsedin Ahmet Beut ka pushuar së funksionuari nga mesi i shek. të 19-të, kur një pjesë e strukturë së saj është zëvendësuar nga Sahatkulla. Ndonëse ishte fillimisht e druritë, kjo kullë u rindërtua me gurë nga Eshref Pashë Rrotulli. Sahati dhe kambana e saj u hoqën në vitin 1912 dhe mbesin të humbura. E lënë pas dore për shumë vite, përpjekjet restauruese të viteve 1970 shndërruan hamamin në Muzen Arkeologjik të Prizrenit, ku shfaqeshin artefakte nga periudha neolitike deri në atë osmane.

Për bienalen e sivjetme, vepra *Lighthouse* ("Fari", 1996) nga Vadim Fishkin transformon kullën në një sinjal të gjallë. Dritat pulsuese, të cilat janë të lidhurat me rrahjet e zemrës së artistit në kohë reale kudo që gjendet, transmetohet përmes teknologjisë mobile. Kjo vepër ka udhëtuar nëpër kontekste të ndryshme dhe tani shndërron monumentin në një fener që sinjalizon vizitorët në rrugëtimin e tyre përgjatë bienales.

Në Muzeun Arkeologjik po ashtu është e ekspozuar vepra *Dark Times* ("Kohë të errëta", 2019-20). Koha është një ndër pyetjet e pasosura, së cilës Fishkin i kthehet rregullisht në praktikën e tij artistike. Koha, si dukuri, përmban dysinë e të qenit edhe fizike, edhe metafizike—pra, edhe objekt i studimit shkencor, edhe forcë plotësisht e pakapshme dhe e pakontrollueshme që formëson çdo aspekt të ekzistencës sonë si qenie të përkohshme. Ndonëse shohim kohën si një ndër normat më objektive dhe e masim me saktësi të lartë, mënyra se si e përjetojmë ndikohet vazhdimisht nga impulset dhe disponimet: koha na duket e shkurtër apo e gjatë, varësisht nga gjendja emocionale në të cilën gjendemi.¹¹

Vadim Fishkin (Ind. 1965) jeton dhe vepron në Lubjanë.

10 Vladimir Vidmar, from the exhibition text for *Dark Times*, DUM Project Space, 2020.

MARIN BARLETI STREET RRUGA MARIN BARLETI



Address: Rruga
Marin Barleti


ARTIST ARTIST: TAO G. VRHOVEC SAMBOLEC


(ENG) An accompanying public program, centered on notions of place and collective experience, runs throughout the biennale. Tao G. Vrhovec Sambolec's work punctuates the program with Tuning In – the neighborhood (2019), a sound event that invites residents of Marin Barleti Street, musicians from the Lorenc Antoni Music School, and the wider Prizren community to attune to the single note “A”—and to one another. This shared ritual of listening, synchronization, and collective performance challenges conventional ideas of public space and activates the city alongside the exhibition works.


Through selected live activations such as Sambolec's, both local residents and visitors are invited to engage with artistic inquiries and creative processes in real time, rather than through mediated documentation. This speaks directly to the biennale's commitment to presence—the impulse to document often stems from the fear of absence.

Tao G. Vrhovec Sambolec (b. 1972) lives and works in Amsterdam.

(ALB) Një program shoqërues publik që përqendrohet te konceptet e vendit dhe të përvojës së përbashkët do zhvillohet gjatë gjithë bienales. Vepra e Tao G. Vrhovec Sambolec-it që mban titullin Tuning In – the neighborhood (2019) është një ngjarje zanore që fton muzikantët, banorët e Rrugës “Marin Barleti” dhe të tërë Prizrenit të Shkollës së Muzikës “Lorenc Antoni” t’i përshtaten notës së vetme “a”, si dhe njëri-tjetrit. Ky ritual i të dëgjuarit, i sinkronizimit dhe i të përformuarit së bashku sfidon konceptet mbi hapësirën pub-







like dhe angazhon qytetin me veprat e ekspozitës. Përmes aktivizimeve të kufizuara të veprave sikur ajo e Sambolec-it, banorët, si dhe njerëzit që vijnë nga më larg, ftohen të përjetojnë pyetjet artistike dhe ecuritë krijuese në kohë reale e jo përmes dokumentimit. Kjo ka të bëjë me këmbënguljen e edicionit të tashëm për prani. Frika e të mos qenit i pranishëm ose e pranishme shpesh qëndron prapa nevojës për dokumentim.

Tao G. Vrhovec Sambolec (Ind. 1972) jeton dhe vepron në Amsterdam.

PUBLIC PROGRAM PROGRAMMI PUBLIK

AUTOSTRADA BIENNALE 5th EDITION EDICIONI I 5 - TË I AUTOSTRADA BIENNALE

(ENG) 5th Edition, July 5 – October 5, 2025
Autostrada Hangar – Center for Contemporary Art

As part of the 5th edition of Autostrada Biennale, we are proud to present a vibrant and inclusive *Public Program* taking place at the Autostrada Hangar – Center for Contemporary Art. Designed to foster dialogue, participation, and curiosity across generations, the program will unfold over the three-month duration of the Biennale, welcoming everyone into the experience of contemporary art.

Exhibition Hours:

All Biennale venues will be open from Wednesday to Sunday, 10:00–17:00. Closed on Mondays and Tuesdays.

Weekly Offerings:

- *Guided Tours* every Thursday and Saturday: Discover the exhibitions and stories behind the works through guided tours led by our team across all Biennale venues.
- *Family Sundays*: A weekly invitation for parents and children to engage in playful and creative learning activities together.

(A L B) 5 korrik – 5 tetor 2025
Autostrada Hangar – Qendra për Art Bashkëkohor

Në kuadër të edicionit të pestë të Autostrada Biennale, kemi kënaqësinë të prezantojmë një *program publik* gjithëpërfshirës dhe dinamik, që do të zhvillohet në Autostrada Hangar – Qendra për Art Bashkëkohor. Programi është konceptuar për të nxitur dialogun, pjesëmarrjen dhe kureshtjen ndërmjet brezave, dhe do të shpaloset përgjatë gjithë periudhës tremujore të Bienales, duke i mirëpritur të gjithë.

Orari i Ekspozitave:

Të gjitha hapësirat ekspozuese të Bienales do të jenë të hapura për publikun nga e mërkura deri të dielën, prej orës 10:00 deri në 17:00. Të mbyllura të hënën dhe të martën.

Programi Javor:

- Vizita të udhëhequra – çdo të enjte dhe të shtunë: Zbuloni ekspozitat dhe tregimet që qëndrojnë pas veprave përmes tureve të udhëhequra nga ekipi ynë në të gjitha hapësirat e Bienales.
- Të Dielat Familjare: Një program i përjavshëm që promovon të mësuarit përmes lojës, bashkëpunimit dhe krijimtarisë ndërmjet prindërve dhe fëmijëve.

AUTOSTRADA BIENNALE OPENING DAYS 4.7-6.7, PRIZREN DITËT E HAPJES

(E N G)

JULY 4 (BY INVITATION ONLY)

Preview Day

JULY 5 (OPEN TO THE PUBLIC)

Exhibitions open across Prizren's historical center—from the Shani Efendi House and Gazi Mehmed Pasha Hammam to the Archaeological Museum, Clock Tower, and other heritage sites—between 10:00 and 17:00. Autostrada Hangars at the ITP zone remain open until 20:00, with artists present throughout the day. At 21:00, we gather at the Autostrada Hangar – Center for Contemporary Art for the Opening Ceremony and Party, celebrating a decade of the Autostrada Biennale.

JULY 6 (OPEN TO THE PUBLIC)

Exhibitions continue across all venues from 10:00 to 17:00. A DJ session at the Autostrada Hangar will take place from 13:00 to 16:00 to close the weekend.

AUGUST HIGHLIGHTS

2-3 AUGUST

In August, we join forces with DokuFest and Kontakt Collection (Vienna) to bring special screenings, talks, and interventions into the space of Autostrada Hangar, bridging visual art and documentary cinema.

SEPTEMBER FOCUS

Throughout September, our public program will deepen its educational outreach, welcoming kindergartens, primary and secondary schools, and university students through tailored workshops, discussions, and guided visits.

CLOSING DAYS – REGIONAL ALLIANCES

3-5 OCTOBER

As we approach the final days of the fifth edition of Autostrada Biennale, we're proud to host a special three-day program in collaboration with the International Biennial Association (IBA). This program will bring together the Berlin Biennale, Istanbul Biennale, Ljubljana Biennale, and other regional partners for a series of conversations, exchanges, and collective reflections. Together, we'll explore common urgencies, strengthen ties, and shape the path toward future collaborations across our biennale network.

For a full agenda of events, talks, and educational activities, please follow us on social media and visit our website.

(ALB)

4 KORRIK (VETËM ME FTESA)

Para-hapje

5 KORRIK (E HAPUR PËR PUBLIKUN)

Ekspozitat hapen në zonën historike të Prizrenit – përfshirë Shtëpinë e Shani Efendiut, Hamamin e Gazi Mehmed Pashës, Muzeun Arkeologjik dhe objekte të tjera të trashëgimisë kulturore – nga ora 10:00 deri në 17:00. Hangarët në zonën e ITP-së do të jenë të hapura deri në orën 20:00, me praninë e artistëve gjatë gjithë ditës. Ora 21:00 Ceremonia zyrtare e hapjes dhe festa do të zhvillohen në Autostrada Hangar – Qendra për Art Bashkëkohor, duke shënuar edhe 10-vjetorin e Autostrada Biennale.

6 KORRIK (E HAPUR PËR PUBLIKUN)

Ekspozitat e hapura në të gjitha hapësirat nga ora 10:00 deri në 17:00. Nga ora 13:00 deri në 16:00, në Autostrada Hangar do të zhvillohet një sesion muzikor me DJ, për të mbyllur fundjavën në një atmosferë të veçantë.

NGJARJET KRYESORE TË GUSHTIT

2-3 GUSHT

Në fillim të gushtit, Autostrada Biennale bashkon forcat me DokuFest dhe Kontakt Collection (Vjenë), për të sjellë një program të veçantë në Autostrada Hangar. Përgjatë dy ditëve, do të prezantohen projeksione filmash dhe biseda të hapura, duke ndërtuar një urë mes artit bashkëkohor dhe kinemasë.

FOKUSI I SHTATORIT

Gjatë gjithë muajit shtator, programi publik i Autostrada Biennale do të thellojë angazhimin e tij edukativ, duke i hapur dyert për grupe nga kopshtet, shkollat fillore dhe të mesme, si dhe për studentë universitarë. Përmes punëtorive të dedikuara, diskutimeve ndërvepruese dhe vizitave të udhëhequra, ftojmë gjeneratat e reja të lidhen drejtpërdrejt me artin bashkëkohor, në një përvojë gjithëpërfshirëse dhe frymëzuese.

DITËT PËRMBYLLËSE – ALEANCA RAJONALE

3–5 TETOR

Në javën përmbyllëse të edicionit të pestë të Autostrada Biennale, kemi kënaqësinë të zhvillojmë një program të dedikuar treditor në bashkëpunim me International Biennial Association (IBA). Ky takim do të mbledhë së bashku Bienalen e Berlinit, Bienalen e Stambollit, Bienalen e Lubjanës, si dhe partnerë të tjerë nga rajoni, për një seri bisedash, shkëmbimesh dhe reflektime të përbashkëta.

Programi synon të trajtojë çështje të përbashkëta, të forcojë lidhjet mes institucioneve pjesëmarrëse dhe të krijojë baza për bashkëpunime të reja brenda rrjetit në rritje të bienaleve. Për agjendën e plotë të ngjarjeve, diskutimeve dhe aktiviteteve edukative, ju ftojmë të na ndiqni në rrjetet tona sociale, të vizitoni faqen zyrtare të bienales ose të na kontaktoni drejtpërdrejt.

Email: info@autostradabiennale.org

Phone: +383 49 415 800

Address: Ukë Bytyqi, nn, ITP Prizren, Kosovo

SPONSORS AND PARTNERS SPONZORËT DHE PARTNERËT

Created by



**AUTOSTRADA
BIENNALE**



AUTOSTRADA HANGAR
CENTER FOR CONTEMPORARY ART

Is made possible with the generous support
and partnerships of

**ALLIANZ
FOUNDATION**



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTRATYVO KULTURE, OMJADINË I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORT



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

giz

Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

ITP

Innovation &
Training Park
Prizren



**BRITISH
COUNCIL**



ProCredit Bank

M
mondrian
fonds

ERSTE

Stiftung



**GOETHE-ZENTRUM
KOOPERATIONSPARTNER**



**ISTITUTO
italiano
di CULTURA**



Embassy of Italy
Pristina



**AMBASSADE
DE FRANCE
AU KOSOVO**

Liberté
Égalité
Fraternité



**Austrian
Embassy
Pristina**



Federal Ministry
Housing, Arts, Culture,
Media and Sport
Republic of Austria



NL Netherlands



Embassy
of the Federal Republic of Germany
Pristina

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP



MINISTRIA E EKONOMISË,
KULTURËS DHE INOVACIONIT



AMBASADA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

ICULTURALB

**k takt
on**

**DOKU
FEST**
International Documentary
and Short Film Festival



iba
International
Biennial
Association

KREATIV GERMANY

PEZULL

swiss arts council
prohelvetia

COLOPHON KOLOFONI

5th Autostrada Biennale
05.07—05.10.2025, Prizren

The fifth edition of the Autostrada Biennale curated by Erzen Shkololli
Edicioni i pestë i Autostrada Biennale
kurrar nga Erzen Shkololli

Unfolding Currents:
The Pulse of Time
Rrymat që Shpalosen:
Pulsi i Kohës

Founding Directors of Autostrada Biennale
Drejtorët bashkëthemelues
të Autostrada Biennale
Leutrim Fishekriu
Vatra Abrashi
Bariş Karamuço

Autostrada Hangar Coordinator
Koordinatorë e Autostrada Hangar
Njomza Abrashi

Production / Produksioni
Giovanni Giacomo Paolin
Pajtim Krasniqi
Admir Abrashi
Ergin Bajraktari
Eren Kazazi

Exhibition Design
Dizajn i Ekspozitës
Walter Kräutler

Installers / Instaluesit
Patrick Burke
Giovanni Dal Sasso

Media and Communication
Media dhe Komunikim
Erza Bata
Tuğhan Anıt

Administration and Finance
Administratë dhe Financa
Njomza Abrashi
Driton Randobrava

Kitchen and Bar of Autostrada Hangar
Kuzhina dhe Bari i Autostrada Hangar
Xhansu Yilmaz
Diona Nojani

Hospitality and Shop
Mikpritja dhe Shopi
Arrita Namlexhiu

Translator EN-AL / Përkthyes
Plator Gashi

Venue Photos
Fotografitë e Hapësirave
Bariş Karamuço

Venue and Artists Texts
Tekstet e Hapësirave dhe Artistëve
Erzen Shkololli

Design / Dizajni
Team Thursday, Rotterdam

Print / Shtypi
Viprint

© 2025
autostradabiennale.org

